


**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**  
**KOMUNA – SUHAREKË**  
**OPSTINE SUVA REKA**  
**THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA**

01.06.22



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA		SUHAREKË SUVA REKA MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
MARRE NË DORËZIM - PRILICEN - RECEIVED			
Nësia org. Org. Jedinica Org. Unit	Numri Bral Number	Shifra Prilag Appendix	Vlera Vrednoft Value
01	320	32598	2

**DREJTORIA PËR BUJQËSI, ZHVILLIM RURAL DHE PYLLTARI**

---

08- Nr. 107

Datë; 01.06.2022

## THIRRJE PËR APLIKIM

Ftohën fermerët e Komunës së Suharekës që të aplikojnë në projektin “Ndërtimi i Serave” në kuadër të programit për zhvillimin e bujqësisë për vitin 2022. Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari ka paraparë që të bëjë ndërtimin e **SERAVE** me participim për kultivuesit e perimeve.

Të drejtën për aplikim e kanë të gjithë fermerët e komunës së Suharekës që i përmbushin kriteret e parapara si:

- Të jetë (fermer ose fermere) – kultivues i perimeve.
- Të jetë i gatshëm - e gatshme të nënshkruaj marrëveshjen me kushtet e përcaktuara nga Komuna e Suharekës.
- Të jetë i gatshëm të kryej participimin prej 20%.
- Të posedojnë tokë bujqësore së paku 0.50 ha.
- Toka ku do të ngritët sera të jetë e përshtatshme për kultivimin e perimeve, të ketë ujë të siguar për ujitje dhe pjerrtësia e parcelës mos të jetë mbi 3%.
- Përfituesit e viteve të kaluara do të jenë të ranguar në shkallën e dytë.

## Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

- Kopja e letërnjoftimit të vlefshëm të Republikës së Kosovës.
- Lista poseduese e tokës - certifikata e pronësisë.
- Kopja e planit të parcelës ku do të vendoset Sera.
- Dëshminë mbi pagesën e tatimit në pronë.

Participimi i fermerëve përfitues të Serave do të bëhet duke bërë pagesën e 20% të vlerës së përgjithshme të serës në llogari të Komunës së Suharekës, ndërsa pjesa tjetër e vlerës apo 80% nga shuma e përgjithshme financohet nga Komuna e Suharekës.

Sera do të monitorohet për 4 vite, ku çdo keqpërdorim i saj do të sanksionohet nga gjykata.

## Informatat dhe data e Aplikimit

Aplikimin fermerët mund ta bëjnë në zyrat e Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari.

Afati i aplikimit fillon prej datës 01.06.2022 deri me datën 14.06.2022

Drejtore i Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari



Ardian Kotëri